



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1123/16 prot.

Datë 17.06.2026

V E N D I M

Nr. 824/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.06.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 732/2026, datë 01.06.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76785-02-19-2026, me objekt “Mirembajtje pajisje elektronike”, me fond limit 1,416,666.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, me Nipt. L81506043D Adresa: Rr. Ali Demi perballe Fushes se Zeze zona kadastrale 8150, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vlore. Adresa: Sheshi “4 Heronjtë” Vlore, 9400.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 01.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 732/2026, ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "INSTANT.AL" SHPK, për procedurën e prokurimit "E hapur, e thjeshtuar", me Nr. REF-76785 02-19-2026, me objekt "Mirembajtje pajisje elektronike", me fond limit 1,416,666.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik "INSTANT.AL" SHPK sipas konstatimeve të vendimit të Komisionin e Prokurimit Publik.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "INSTANT.AL" SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë."

I.2. Me shkresën nr. 3489/19 prot., datë 08.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1123/13 prot., datë 12.06.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Vlore, ka përcjellur rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas pjesës arsyetuese të vendimit nr. 732/2026 datë 01.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të tij për procedurën e prokurimit "E hapur, e thjeshtuar", me Nr. REF-76785-02-19-2026, me objekt "Mirembajtje pajisje elektronike", me fond limit 1,416,666.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 3489/19 prot., datë 08.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1123/13 prot., datë 12.06.2026, autoriteti kontraktor Bashkia Vlore, ka përcjellur rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas pjesës arsyetuese të vendimit nr. 732/2026 datë 01.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të tij për procedurën e prokurimit "E hapur, e thjeshtuar", me

Nr. REF-76785-02-19-2026, me objekt "Mirembajtje pajisje elektronike", me fond limit 1,416,666.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se autoriteti kontraktor ka bashkëngjitur dokumentat nga ku vërehen rivlerësimi sipas vendimit nr. 732/2026 datë 01.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga verifikimi i sistemit elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik konstatohet se autoriteti ka vijuar me rivlerësimin sipas vendimit të KPP për operatorin ekonomik duke zbatuar kështu vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "E hapur, e thjeshtuar", me Nr. REF-76785-02-19-2026, me objekt "Mirembajtje pajisje elektronike", me fond limit 1,416,666.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro



Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2026/06/18 10:46:47 +02'00'
8eea809eb0a2426589208745dfa193ce2026061810464
628020

Digitally signed by
Fiorent ZGURU
Date: 2026.06.18
02:08:41